



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 394/2014

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtarët: Ferit Osmani kryesues, Ymer Hoxha, dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Murat Hoxha nga subjektit politik Lidhja Demokratike Kosovës (LDK), dega në Gjilan, paraqitur kundër rezultatit përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 26.06.2014, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 30.06.2014, mori këtë:

#### VENDIM

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e kandidatit për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës – Murat Hoxha nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Gjilan.

#### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 27.06.2014, nga kandidati për deputet të Kuvendit të Republikës së Kosovës- Murat Hoxha me nr. 31 të subjektit politik LDK në Gjilan, me të cilën pretendohet se në FRK të vendvotimit nr. 0401D/03, nuk shihen numri i votave të kandidatit nr 31. Parashtruesi i ankesës kërkon që të verifikohet numri i votave prej 52 vota dhe ti regjistrohen në numrin 31.

Parashtruesi i ankesës në cilësinë e dëshmisë ka bashkangjitur formularin e raportimit nga vëzhguesi i VV 0401D/03R dhe kopja e FRK-së.

Bazuar në nenin 117. 2 të LZP-së PZAP-i “*Gjatë vendosjes për një ankesë apo apel PZAP-i shqyrton dhe heton të gjitha dëshmitë relevante dhe mundëson seancë dëgjimore në rast se konsideron këtë të nevojshme*”

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën dhe bëri hetimin e fletëvotimeve të kontestuara gjeti se:

**ankesa është e pabazuar**

PZAP-i, ka zhvilluar hetimet për të vërtetuar themelësinë e pretendimeve ankimore të parashtruara nga kandidati për deputet - Murat Hoxha të subjektit politik LDK në kuptim të nenit 12.1 të Rregullave dhe Procedurave të tij, ka caktuar një hetues kryesor dhe një zyrtar të lartë ligjor nga sekretariati për ta bërë administrimin e hetimeve të materialit zgjedhor në QNR, për të cilat kandidati në fjalë pretendon se në vendvotimin me nr. 0401D/03R, ka pasur 52 vota të cilat në FRK nuk janë shënuar apo nuk shihen fare sipas parashtruesit të ankesës.

PZAP-i, ka konstatuar nga FRK-ja origjinale në QNR se janë të shënuara 52 vota lidhur me VV 0401D/03R sa i përket kandidatit të lartpërmendur e jo ashtu siç pretendohet në ankesë që nuk është shënuar asnjë votë apo që nuk shihet që ka vota në FRK. Prandaj për këtë arsye edhe nuk është hapur fare kutia e votimit për rastin në fjalë sepse votat e kandidatit të lartpërmendur kanë qenë të shënuar në FRK dhe të njëjta janë përfshirë në rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve të publikuar nga KQZ-ja.

Andaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së lidhur me ankesën e lart përmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia në Prishtinë**

Anr. 394/2014 më datën 30.06.2014



#### ***Udhëzim Juridik:***

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*